



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BUJQWSISW, E PYJEVE, E KULLOTAVE DHE E UJITJES**

Nr. 4614 prot.

Himarë, më 23.06.2026

Lënda: Dërgim projektvendimi për miratim

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË,**



Himarë

Të nderuar këshilltarë,

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin “Per miratimin e planeve te mbareshtimit per Ekonomite Pyjore “ Gjomolle ” dhe “ Papadhi – Cipin”. Bashkëngjitur gjendet:

- projektvendimi i përmendur më lart;
- relacionet mbështetëse për këtë projektvendim;

**DREJTOR**

**Arjan Panajoti**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHER**

**ZEVENDESKRYETARI**

**Erifili Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE I UJITJES

Nr. 4614 Prot.

Himarë, më 23.06 2026

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 44, DATË 23.06.2026

**“PËR  
MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT PER KONOMITË  
PYJORE “GJOMOLLE DHE PAPADHI – ÇIPIN”.**

**Të nderuar këshilltarë !**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”; të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar”. Mbështetur në “Kontratën e Shërbimit”, lidhur ndërmjet, Bashkisë Himarë dhe subjektit “**Lurimi**” sh.p.k, Diber-Burrel-Albania, me Nipt: **J68403912U**, përfaqësuar nga administrator Lutfi Miftari, me objekt: “Hartim Plani menaxhimi ekonomia pyjore “Gjomolle dhe Papadhi – Cipin”. Bashkia Himarë me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtoria e bujqesise ,pyjeve .kullotave dhe ujitjes (sektori i pyje kullotave ) pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga nga ky sektor ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërish, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Himarë që në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026 të miratojë:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planin e mbarështimit te ekonomisë pyjore “ppadhi Cipin dhe Gjomolle”, të hartuar nga Subjekti “Lurimi” Shpk me NIPT: **J68403912U**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Bujqesise ,Pyjeve ,Kullotave dhe Ujitjes , Drejtoria e Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiare.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. U shpall sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHËR  
ZËVENDËSKRYETARI**

**Erifili Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE I UJITJES

4514/2  
Nr. Prot

Himarë, më 23.06.2026

## RELACION PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE  
EKONOMIA PYJORE GJOMOLLE”.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

### Baza Ligjore:

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, të pikes 1 nënpika 1.1, shkronja “a” të nenit 9, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k” të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 11 pika 2/b e ligjit Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet; ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”.

Mbështetur në “Kontratën e Shërbimit”, lidhur ndërmjet, Bashkisë Himarë dhe subjektit “Lurimi” sh.p.k, Diber-Burrel-Albania, me Nipt: **J68403912U**, përfaqësuar nga administrator Lutfi Miftari, me objekt: “Hartim Planit të menaxhimit të ekonomisë pyjore gjomolle.

Gjatë marrjes në dorëzim dhe vlersimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kullor që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Himarë është konstatuar se plani i mbarshimit të ekonomisë pyjore gjomolle është mbarështuar për herë të fundit në vitin 1985, ekonomia gjatë këtyre viteve ka pësuar ndryshime të mëdha dhe mjaft të ndjeshme, në konjekstin përse i

përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit sipas klasave të moshës dhe prodhimit. Prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe njëkohesisht duke mos mohuar për punën e bërë për hartimin e planit të vjetër kalimi i një pjese të kësaj ekonomie nga prone shtetërore në pronësi të bashkisë, ku kërkesat për hartimin e këtij plani është rritur, pra për aresyet e mësipërme u pa e domozdoshme hartimin e këtij plani i cili do të pasqyrojë gjëndjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrime të ndryshme si ajo e prodhimitarise, ruajtjes së terrenit dhe me një seriozitet është studjuar gjëndja e vleresimi i biodiversiteti në përgjithësi.

Plani mbareshtimit i ekonomisë është hartuar në bazë të manualit të mbarështrimit të miratuar nga Ministria e Mjedisit si për punimet e terrenit ashtu dhe për ato të zyrës. Në këtë plan mbareshtimi një vend të rëndësishëm zë sigurimi i një mbareshtimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit.

Objektivi i përgjithshëm është përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve, mbi bazen e kërkesave bashkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre me qëllim që të percaktohen realisht potenciali i tyre prodhues, duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin. Është synuar ndërthurja e të gjithë faktoreve që lidhen direkt dhe indirekt midis tyre p.sh popullatat lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, përmirësimi i pejsazhit rural, ruajtjen e natyres. Po ashtu do të synohet plotësimi i kërkesave me lende ndertimi dhe e dru zjarri, prodhime të dyta pyjore, baze ushqimore për blegtorinë.

Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në reference të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i cili ka përcaktuar afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarështrimit 10 vjeçar.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikën dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për zhvillimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare.

Mbarështimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit. Shfrytëzimi dhe përdorimi i resurseve natyrore është vlerësimi i drejtë i pyjeve të kësaj ekonomie, në të njëjtën kohë është dhe një hap para dhe si faktor i domosdoshëm për ruajtjen e ekuilibrit të mjedisit, në të njëjtën kohë është dhe një rregullator i mirefillte në ruajtjen e regjimit hidrik. Është detyrë përsosore që me zbatimin e masave silvoteknike që do të hartohen e zbatohen në këtë plan mbareshtimi që grumbujt pyjorë të arrijnë qëllimin kryesor e final, sipas regjimit të tij.

Synimet që do të arrihen në zbatimin e këtij plani janë:

- Hartimi i masave silvoteknike në trajtimin e pyjeve që do të shprehet dhe në rritjen e prodhimitarise e të gjitha elementet e duhur.
- Menaxhimi me kritere të efektshme ekonomike me efektivitet të qëndrueshëm ekonomik gjatë shfrytëzimit racional të burimeve natyrore
- Hartimi dhe miratimi i këtij projekti është baza e fillimit të ushtrimit të masave silvoteknike, dhe kryerja e një menaxhimi të mirefillte të të ardhurave ekonomike, e një të ardhme të një grumbulli pyjor me parametra të prekshëm.

Gjate tranzicionit dhe periudhes se tanishme, pyjet nuk jane trajtuar mire sipas planeve te mbareshtimit, ne pergjithesi pyjet jane demtuar nga prerjet pa leje, kjo vjen si rezultat i mungeses se lendes djegese (dru zjarri), dhe varferise te komunitetit qe jeton brenda ekonomise pyjore.

Planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të sektorit të pyjeve e kullotave të bashkise përkatëse:

Fondi pyjor dhe kullosore i ekonomisë pyjore si dhe kategoritë e përdorimit të tokës brenda territorit të ekonomisë pyjore **Gjomolle**.

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarshtrimit 2026-2035

### I. PËRDORIMI I TERRIORIT

Sipërfaqja totale është **1483.9** ha, sipas planit të menaxhimit të hartuar, kjo sipërfaqe është krahasuar me VKM dhe planin e vjetër të menaxhimit viti 1985, ku 1179.1 ha janë kategoria e përdorimit të territorit pyll, 236.2 ha janë të kategorise kullote dhe sipërfaqe jo productive rreth 68.6, të cilat janë të paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Përdorimi i tokës (ha)	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështimit 1985	Sipas Planit të Mbarështimit 2026	Ndryshimi midis vkm dhe PMK Aktual
Pyll	1416.2	1418.7	1179.1	-237.1
Kullotë	0	0	236.2	236.2
Sipërfaqe me bimësi pyjore	3	3	0	-3
Djerr	10.2	50	0	-10.2
Sipërfaqe inproduktive	23.35	10.2	68.6	45.25
<b>Gjithsej</b>	<b>1452.75</b>	<b>1481.9</b>	<b>1483.9</b>	<b>31.15</b>

Ashtu sikurse vërehet, ka një shtesë prej 31.15 ha në total të sipërfaqes së ekonomisë pyjore, krahasuar me sipërfaqen e dhënë në VKM, por krahasuar me vitin e inventarizimit 1985 kemi një shtesë prej 2 ha. Kjo shtesë vjen për arsyt e mëposhtme:

1. Parcelat eksistuese të EP Gjomolle me Nr. 1, 2, 5, 6, 7, 8 të cilat të cilat kanë perberje drure shume të rralle të moçem valanidhi, si dhe prania e larte e blegtorisë dhe vlersimit aktual të dala nga inventarizimi ben që të propozohen kullote me drure si dhe pakesimi me 237.1 ha vjen si rrjethoje e propozimeve dhe masave të dala nga plani i

inventarizimit, si dhe shtesa ne kullota lidhet me kullotat mbi Porto palermo dhe gjëndjes floristike dhe karakteristike qe ato kane.

2. Kategoria Djerr sipas planit të mbarshimit 1985 kemi 50 ha ndersa sipas vkm kemi 10.2 ha, plani aktual nuk ka sipërfaqe kjo per arsye te suksesionit ekologjik natyror pozitive dhe ndryshimeve që grumbulljt e kesaj ekonomive kane bere nder vite.
3. Kategoria e perderimit shkembore kjo ne planin aktual ka 68.6 ha e cila i referohet ngastrave 34b, dhe 27d, te cilat jane evidentuar nga inventarizimit aktual, ngastrat 11b; 13c; 14d i referohet ndertimit i rruges qeparo-kuç ka bere që skarpatat e rruges si dhe sterilet nga aksidentimit të rezultojne shkembore, ndersa ne ngastren 10b jane planifikuar pyllezim ne objektivat e ketij plani mbarshimi. Ngarkohet kjo strukturë që pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij plani mbarështrimi të bëjë përditësimet kadastrale, mbështetur në aktet ligjore në fuqi.
4. Po ashtu, përdorimi i programeve kompjuterike në hartografim nëpërmjet programit GIS, gjeoreferencimit të konturittë parcelave, nënparcelave dhe atij të jashtëm të ekonomisë pyjore Gjomolle, ka rritur saktësinë e matjes, duke rritur kësisoj sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë.

## II. TIPET E KULLOTAVE

Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej 236.2 ha në EP Gjomoll është ndarë sipas tipeve dhe shkallës së mbulesës barishtore. Tabelat dhe grafikët më poshtë evidentojnë gjendjen mesatarisht të mirë të tokave kullosore, pasi më së shumti janë të përziera me drurë dhe bimësi të rrallë pyjore.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (në ha)	% of totalit të sipërfaqes kullosore	% e totalit të së zonës së studimit
Kullotë verore	0		0
Kullotë dimërore	236.2	100 %	15.9
<b>Totali</b>	<b>236.2</b>	<b>100%</b>	<b>15.9</b>

Ne ekonomine pyjore EP Gjomoll perفشihet nje sipërfaqe prej 236.2 ha. Periudha e kullotjes eshte gjate gjithe vitit kjo per arsye se kullotata jane dimerore. Per shkak te numurit te krereve te bagetise dhe perdorimit kolektiv te saj ka nje rendiment te kullotes. Shfytezimi behet duke u dhene liri kopeve te dheneve te gjejne ushqim sipas deshires se tyre ne te gjithe sipërfaqen dhe per gjithe sezionin kullosor.

### III. NDERHYRJET PRERJET E LEJUARA.

Në total ekonomie, për formën e qeverimit trungshte, do të përshkohen me ndërhyrje silvikulturale, nga ku do të rezultojnë 2550.2 m<sup>3</sup> lëndë drusore.

Do të kryhen tipe të ndërhyrjeve silvikulturale dhe shfrytezime sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Forma e qeverisjes	Ndërhyrja	Volumi (m <sup>3</sup> )
1	TRUNGISHTE	Rrallim Tip I	644.4
2		Kop.dr.vec	1905.8
A	<b>Total shtresa (1+2)</b>		<b>2550.2</b>
3	CUNGISHTE/SHKURRE	Shfrytëzim cungishte me breza	4060
4		Permirsime	209
5		Prerje sanitare	743
6		Pastrim	1067
B	<b>Total shtresa (3+4+5+6)</b>		<b>6079</b>
<b>Gjithsej (m<sup>3</sup>) (A+B)</b>			<b>8629.2</b>

Në cungishte dhe shkurre kemi me një volum të përgjithshëm prej 6079 m<sup>3</sup>, duke përfshirë ndërhyrje si: prerje sanitare, permirsime, pastrime, shfrytezime me breza për formën e qeverisjes shkurre, dhe për të tre format e qeverisjes me një volum prej 8629.2 m<sup>3</sup> kjo në harkun kohor 10 vjeçar të zbatimit të punimeve të propozuara në këtë plan mbarshimi. Këto punime do të aplikohen me intensitet të ulët dhe të mesëm deri në të lartë të prerjeve.

### IV. PLANI I INVESTIMEVE DHE TË ARDHURAT.

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar tabelën e investimeve në planin 10 vjeçar të investimeve.

Nën/parcela	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja e planifikuar për pyllëzim në (ha)	Metoda e mbjelljes	Skema e mbjelljes	Kostoja e Pyllëzimit në (Leke)	
					1 ha	Totali
VL28 00 010b	12.12	5.45	Me fidana	2x1.5	229220	1249249
<b>Shuma:</b>	<b>12.12</b>	<b>5.45</b>	<b>Me fidana</b>	<b>2x1.5</b>	<b>229220</b>	<b>1249249</b>

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat nga lenda drusore sipas prerjeve të lejuara gjatë zbatimit 10 vjeçar të punimeve dhe qerat nga maksimizimi i të ardhurave të kullotave etj.

Nr	Lloji i punimit	Njësia	Sasitë (sipas ndërhyrjeve në 10 vjet)	Shpenzimetgjithsej (Lekë)
1	Prodhim i lëndës drusore	m <sup>3</sup>	21449	69709250
2	Pyllëzim	ha	5.45	1249249
3	Blerje fidanësh	copë	18164	2088860
4	Merimetim lere	copë	1	980000
5	Masat në Kullota	ha	78.3	610740
	<b>Gjithsej</b>			<b>74,638,099</b>

#### V. VOLUMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISË PYJORE.

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, pasi të dhënat u bartën në programin e përpunimit të të dhënave MS Access DB, të miratuar nga Këshilli Shkencor i ish Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave në vitin 2000, rezultoi se EP Gjomoll ka një volum të përgjithshëm në këmbë prej 56651 m<sup>3</sup>. Ashtu si më sipër kemi theksuar, volumi i përket vetëm formave të qeverimit Trungishte, cungishte dhe shkurre.

Të dhënat për shpërndarjen e volumit jepen në tabelën më poshtë.

Forma e qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar m <sup>3</sup> /vit	Vol. total në këmbë (m <sup>3</sup> )
Trungishte	446	58.25	25978
Cungishte	287.1	56.63	16259
Shkurre	433.9	32.21	14414
<b>Gjithsej</b>	<b>1167</b>		<b>56651</b>

Ashtu sikur mund të vërehet edhe nga tabela më sipër, dominancën e volumit në ekonomi e mban forma e qeverimit Trungishte e cila sigurisht që është në porpacion të drejtë edhe me madhëinë e sipërfaqes. Volumi total i EP Gjomoll llogaritet në një total prej 56651 m<sup>3</sup>, e gjendur kjo në sipërfaqen pyjore prej 1167 ha, dhe me një volum mesatar (të llogaritur) 48.54 m<sup>3</sup>/ha.

Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, fondi pyjor dhe kullor qeveriset bazuar në planet e mbarshimit që përbëjnë dokumentet bazë për mbarshimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjëndjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion

të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Plani i ri i mbarshtrimit të ekonomisë pyjore përcaktohen hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë menyrë investimeve në fodin pyjor dhe kullor nëpërmjet:

- a) Pyllëzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara
- b) Shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve për nevojat publike
- c) Rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryrjet/ erozioni
- d) Rritjen e prodhimit të lendës drusore

Nga ana tjetër përmes këtij procesi arrijmë të realizojmë plane të tilla për pyjet, të cilët janë një bazë e mirë për çertifikimin e pyjeve të bashkisë bazuar në rregulloret FLEGT dhe EUTR të BE-si dhe ligjin Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, duke garantuar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në territorin e bashkisë.

Referuar nenit 11, pika 2 shkronja “b” të ligjit 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, përcaktohet se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore si dokument bazë afat gjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të çertifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përjashtimisht për Bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës.

Në këto kushte, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (struktura e shërbimit pyjor) në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin, shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kullor pjesë e territorit të Bashkisë Himarë, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, ***propozon Këshillit Bashkiak Himarë për miratimin paraprak si dhe Ministrisë Mjedisit, në cilësinë e organit vendimarrës, miratimin përfundimtar të Projekt Draft planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Gjomoll”.***

1. Mbarshtrimi është planifikimi afatgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kritereve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/ gjëndjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat administruese, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.
2. Ekonomi pyjorë është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarshtrimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

**PËRGATITI MATERIALIN:**

**Konceptuan:**

**Specialist Pyjesh:**

**Ing. Ilija Dhimojani**

**Miratoi:**

**DREJTOR**

**Arjan Panajoti**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHËR**

**ZËVENDËSKRYETARI**

**Erifili Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE I UJITJES**

Nr. 461H/3 Prot.

Himarë, më 23.06 2026

**RELACION  
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT**

**“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHITIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE  
EKONOMIA PYJORE PAPADHI ÷ CIPIN .**

**I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !**

**TË NDERUAR KËSHILLTARE !**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

**Baza Ligjore:**

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, të pikes 1 nënpika 1.1, shkronja “a” të nenit 9, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k” të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 11 pika 2/b e ligjit Nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet; ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”.

Mbështetur në “Kontratën e Shërbimit”, lidhur ndërmjet, Bashkisë Himarë dhe subjektit “Lurimi” sh.p.k, Diber-Burrel-Albania, me Nipt: **J68403912U**, përfaqësuar nga administrator Lutfi Miftari, me objekt: “Hartim Plani të manazhimit të ekonomisë pyjore papadhi cipin Gjatë marrjes në dorëzim dhe vlersimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kullor që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Himarë është konstatuar se plani i mbarshimit

konkrekstin përsa i përket strukturës ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit sipas klasave të moshës dhe prodhimit. Prandaj duke u nisur nga këto arsye dhe njëkohesisht duke mos mohuar për punën e bërë për hartimin e planit të vjetër kalimi i një pjese të kësaj ekonomie nga prone shtetërore në pronësi të bashkisë, ku kërkesat për hartimin e këtij plani është rritur, pra për arsyet e mësipërme u pa e domozdoshme hartimin e këtij plani i cili do të pasqyrojë gjëndjen reale të grumbujve, duke i parë në këndvështrime të ndryshme si ajo e prodhimitarise, ruajtjes së terrenit dhe me një seriozitet është studjuar gjëndja e vleresimi i biodiversiteti në përgjithësi.

Plani mbareshtimit i ekonomisë është hartuar në bazë të manualit të mbarështrimit të miratuar nga Ministria e Mjedisit si për punimet e terrenit ashtu dhe për ato të zyrës. Në këtë plan mbareshtimi një vend të rëndësishëm zë sigurimi i një mbareshtimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit.

Objektivi i përgjithshëm është përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve, mbi bazën e kërkesave bashkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre me qëllim që të përcaktohen realisht potenciali i tyre prodhues, duke mbrojtur biodiversitetin dhe mjedisin. Është synuar ndërthurja e të gjithë faktoreve që lidhen direkt dhe indirekt midis tyre p.sh popullatat lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, përmirësimi i pejsazhit rural, ruajtjen e natyrës. Po ashtu do të synohet plotësimi i kërkesave me lende ndertimi dhe e dru zjarri, prodhime të dyta pyjore, baze ushqimore për blegtorinë.

Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në reference të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i cili ka përcaktuar afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarështrimit 10 vjeçar.

Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikën dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për zhvillimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare.

Mbarështimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit. Shfrytëzimi dhe përdorimi i resurseve natyrore është vlerësimi i drejtë i pyjeve të kësaj ekonomie, në të njëjtën kohë është dhe një hap para dhe si faktor i domozdoshëm për ruajtjen e ekuilibrit të mjedisit, në të njëjtën kohë është dhe një rregullator i mirefillte në ruajtjen e regjimit hidrik. Është detyrë për përdoruesit që me zbatimin e masave silvoteknike që do të hartohen e zbatohen në këtë plan mbarështrimi që grumbujt pyjorë të arrijnë qëllimin kryesor e final, sipas regjimit të tij.

Synimet që do të arrihen në zbatimin e këtij plani janë:

- Hartimi i masave silvoteknike në trajtimin e pyjeve që do të shprehet dhe në rritjen e prodhimitarise e të gjitha elementet e duhur.
- Menaxhimi me kritere të efektive ekonomike me efektivitet të qëndrueshëm ekonomik gjatë shfrytëzimit racional të burimeve natyrore
- Hartimi dhe miratimi i këtij projekti është baza e fillimit të ushtrimit të masave silvoteknike, dhe kryerja e një menaxhimi të mirefillte të të ardhurave ekonomike, e një të ardhme të një grumbulli pyjor me parametra të prekshëm.

Gjate tranzicionit dhe periudhes se tanishme, pyjet nuk jane trajtuar mire sipas planeve te mbarshtrimit, ne pergjithesi pyjet jane demtuar nga prerjet pa leje, kjo vjen si rezultat i mungeses se lendes djegese (dru zjarri), dhe varferise te komunitetit qe jeton brenda ekonomise pyjore.

Planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të sektorit të pyjeve e kullotave të bashkise përkatëse:

Fondi pyjor dhe kullosore i ekonomisë pyjore si dhe kategoritë e përdorimit të tokës brenda territorit të ekonomisë pyjore **Papadhi Çipin**

Të dhënat kryesore sipas planit të mbarshtrimit 2026-2035

## I. PËRDORIMI I TERRIORIT

Sipërfaqja totale e EP Papadhi Çipin, e përfshirë në këtë plan mbarështimi në përputhje me VKM e transferimit është 6858 ha.

Nga kjo janë gjetur:

- Sipërfaqe pyjore 4292 ha
- Sipërfaqe me bimësi pyjore 849.1 ha
- Kullota 1252 ha
- Jo-prodhuese 380.8 ha
- Djerr 5.4 ha

Që të gjitha format e përdorimit sa më sipër janë në pronësi të Bashkisë Himarë, ndërsa brenda konturit të ekonomisë bëjnë pjesë edhe format e ërdorimit me pronësi private si:

- Toka bujqësore 70.8 ha
- Zona banimi (troje) 7.6 ha



Në formë tabelare dhe diagrami të dhënat e mëposhtme paraqitën në tabelën nr. 2.1, më poshtë. Theksojmë se kjo tabelë është produkt i përpunimit të të dhënave me programin Access DB.

Sipas planit të Mbarështimit të vitit 1985, Ekonomia Pyjore Papadhi Çipin, rezulton me një sipërfaqe të përgjithshme prej 6600 ha, e kategorizuar kjo në **5545.89 ha sipërfaqe pyjore**, ku nga kjo 2069.39 ha, janë pyje trungishte, 120.25 ha janë pyje cungishte dhe shkurret zënin 3357.25 ha.

Ndërsa diferenca tjetër prej 1054 .39 ha, kategorizohet në 361.5 ha si kullotë/livadhe, 438.9 ha si sipërfaqe jo prodhuese (inproduktive) përfshirë edhe sipërfaqet ujore (shtretër lumenjsh) dhe 254.1 ha ishin kategorizuar si toka bujqësore apo troje e vendbanime.

Në vitin 2016, në sajë të reformës së decentralizimit të funksioneve administrative drejt Njësite të Vetqeverisjes Vendore, fondi pyjor dhe kulloror i cili administrohej nga Ministria përgjegjëse për pyjet (në atë kohë ish Ministria e Mjedisit), u transferua drejt pushtetit vendor dhe EP Papadhi Çipin konkretisht, drejt administrimit nga bashkia Himarë. Në formë tabelare, përdorimi i territorit paraqitet si vijon:

Perd.territorit	Aktuale	E propozuar
	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja ha
<b>Total</b>		
Pyll	4292.0	4292.0
Sip.me bim. pyjore	849.1	849.1
Bujqesi	70.8	70.8
Kullote, Livadh	1252.3	1252.3
Urbane	7.6	7.6
Ujore	0.0	0.0
Kenete, Mocal	0.0	0.0
Djerr	5.4	5.4
Joproductive	380.8	380.8
<b>Total:</b>	<b>6858.0</b>	<b>6858.0</b>



Por le të marrim në analizë se si kanë evoluar sipërfaqja pyjore në këtë periudhë rreth 40 vjeçare në EP Papadhi Çipin.

Viti i planit	1985	2026	Dif.	Arsyet
Sipërfaqe pyjore totale (ha)	5549.89	4292	-1258	Për shkak të zjarreve dhe dëmtimeve një sasi e konsiderueshme e sipërfaqes ka kaluar në sipërfaqe me bimësi pyjore dhe një pjesë e tjetër

				aktualisht konsiderohen si kullotë për shkak
a. Trungishte	2068.39	1339.6	- 729	Dëmtuar nga zjarret, kryesisht, por edhe prerjet ilegale gjatë viteve
b. Cungishte	120.25	1529	+ 1409	Ndryshim evolutiv progresiv, nga forma e qeverimit shkurre
c. Shkurre	3357.25	1423	- 1934	Kanë kaluar në një formë qeverisje me të avancuar, kryesisht cungishte
Sipërfaqe jo pyjore	1054.5	2566	1512	Zjarret dhe keqadministrimi
Sip.me bimësi pyjore (SBP)	0	849	+849	Shtuar si kategori e re nga ligji 57/2020. Mbulesa më e vogël se 10% nga bimësia pyjore
Kullota	361.5	1252.3	+890.8	
Sipërfaqe joproductive	438.9	380.8	- 58.1	Një pjesë e këtyre sipërfaqeve kanë kaluar në kategorinë SBP
Toka bujqesore/troje	254.1	78.4	-157.7	Janë përjashtuar nga transferimi për shkak të pronësisë private.
<b>TOTAL EP</b>	<b>6600.39</b>	<b>6858.0</b>	<b>+258</b>	Shtesa për shkak të korrektimit digjital të sipërfaqeve (hartografim GIS)

## II. TIPET E KULLOTAVE

Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave në EP Papadhi Çipin është 1253 ha. Të vendosura mbi formacione karbonike dhe mbi toka skeletike ato e vuajnë thatësinë, megjithatë në pranverë dhe verën e hershme janë shumë të pasura me lloje dhe shumë të ushqyeshme për blegtorinë.

Ajo shtrihet në parcelat që konturojnë pjesën jllindire dhe jugore të EP. Toponimi popullor njihet me emrin Mali i Çipinit.. Kullotat janë përdorur historikisht pa kufizime nga fshatrat në afërsi të saj, të tillë si Bolena, Brati, Tërbaçi, etj.

Me gjithëse vihet re një rënie e ndjeshme e përdorimit të kullotës, sërish ajo vazhdon të frekuentohet si nga vendasit ashtu edhe nga shtegtarët nëpërmjet staneve.

Nga diskutimet me banorët vendas, pas viteve 2020, kullota ka një rënie të ndjeshme. Më parë ajo frekuentohej nga blegtorë të cilët shfrytëzonin kullotën në stinën e verës. Mungesa e rrugëve (tashmë edhe ajo e kafshëve është totalisht e prishur dhe as kalimi i tyre nuk mundëshet), por edhe rënia e ndjeshme e interesit të banorëve të zonës për të mbarështuar blegtori, ka bërë që kjo kullotë të lihet nën suksesionin natyror dhe së shpejti vendin e saj ka shumë gjasa që ta zënë stade të tjera më të avancuara të bimësisë.

Infrastruktura e kullotave (veprat ujëpirëse, lera korita, stane-ngrehina) është thuajse ineksistente. Vëtë shtegtarët mundohen të krijojnë kushtet e qëndrimit në stane, por kjo lë shumë për të dëshiruar në aspektet e lehtësirave të jetesës, ashtu dhe sa i takon shfrytëzimit të kullotës.

Në këtë plan mbarështimi nuk janë parashikuar masa ndërhyrje në kullota, duke parë që interesi i përdorimit të tyre është krejt papërfillshëm.

### **III. NDERHYRJET PRERJET E LEJUARA.**

Më një konfiguracion terreni që ka pjerrësi të konsiderueshme, një sasi e konsiderueshme e grumbujve pyjore u është dhënë funksioni mbrojtës. Grumbujt pyjorë me këtë funksion do të përjashtohen 100% nga llogaritja e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. Kjo pasi pjerrësia e terrenit nuk garanton ripërtëritjen dhe rikthimin e vegjetacionit aq më shumë në rrethanat e ndryshimeve klimatike.

Si rezultat mundësia vjetore e shfrytëzimit do të përqendrohet vetëm në pyjet me funksion “mbrojtës+prodhues” dhe prodhues nga ku edhe në këtë rast lejohen të ndërhyhet vetëm me prerje kopshtore (me dru të veçantë).

Ndërhyrjet me prerje rrah apo me breza, janë planifikuar vetëm në sipërfaqet apo grumbujt pyjor me funksion prodhues, ku pjerrësia e terrenit nuk i kalon 40%. Kjo metodë ndërhyrje është propozuar në kuadër të tendencës për të siguruar një formë qeverimi më të avancuar për grumbullin. Në rastin në fjallë synohet që nga forma e qeverimit shkurre grumbulli të mund të konvertohet në një formë qeverimi cungishte, kuptohet atje ku munri i dushqeve p.sh e mundëson një gje të tillë.

Duke qenë se normalizimi i klasave të moshës në funksion të harmonizimit dhe balancimit të sipërfaqes për secilën prej tyre është një kusht i domosdoshëm për të garantuar vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e grumbullit, do të synojmë që të krijojmë ciklin e munguar në këtë EP.

Ashtu si më sipër theksuam, cikli do të synohet të arrihet vetëm në grumbujt pyjorë me funksion prodhues dhe me atë “Mbrojtës+Prodhues”. Për pasojë sipërfaqja nën masa e objektiva do të jetë vetëm 2958 ha e kësaj ekonomie dhe jo pjesa tjetër.

Për të patur një orientim mbi sipërfaqet dhe volumet respektivë, po i referohemi sërish volumeve respektive që do të kenë si funksion prodhimin.

Forma qeverimit	e	Volumi (në m <sup>3</sup> ) sipas Funkcionit		TOTALI
		Prodhues	Mbrojtës	
1	Trungishte	33'237	123'124	156'361
2	Cungishte	28'774	19'819	48'593
3	Shkurre	4668	0	4668
TOTALI		66'679	142'943	209'622

Gjendja e grumbujve me funksion prodhues në EP Papadhi Çipin, përshtaten vetëm me metodën Von Mantel, për llogaritjen e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. Sipas kësaj metode, volumi që do të hiqet për çdo vit, llogaritet duke pjesëtuar 2 fishin e volumit (2\*V) në këmbë për çdo formë qeverimi me R-cikli i prodhimit.

Pra  $AAC = 2*V/R$ , ku:

AAC = Mundësia vjetore e shfrytëzimit

R = periudha e rrotacionit (cikli i prerjes) për speciet kryesore të grumbullit në kembe në vite

V = volumi mesatar i specieve kryesore të grumbullit me  $d > 7$  cm, në m<sup>3</sup>

Si rezultat, për formën e qeverimit trungishte, duke llogaritur që cikli I prerjes për llojet kryesore është 100 vjet, gjejmë:

$AAC = 33207*2 / 100 = 664 \text{ m}^3/\text{vit}$ , për pyjet me formë qeverimi trungishte

Për pyjet me formë qeverimi cungishte duke konsideruar mbi bazën e llojeve të gjetura në EP, se cikli I prerjes është 40 vjet, gjejmë:

$AAC = 28774*2 / 40 = 1438 \text{ m}^3/\text{vit}$ , për pyjet me formë qeverimi cungishte.

Për formën e qeverimit shkurre duke mbajtur parasysh që cikli I prerjes në kushtet e EP Papadhi Çipin është 30 vjet, dhe mbështetur në të dhënat e tabelës VII.1.1, më sipër, ku shkurret në klasën e moshës 20-25 vjet ofrojnë vetëm 2661 m<sup>3</sup>, logjikisht në vitin e 30 kësaj sasi I duhen edhe 5 vjet të tjera për të arritur pjekurinë për ndërhyrje. Si rezultat vetëm ½ e kësaj sasi do të planifikohet për ndërhyrje në 10 vitet në vijim të maturimit të këtij PM.

Nga sa më sipër rezulton së mundësia vjetore e shfrytëzimit në shkurre do të ishte:

$AAC = 1330.05*2 / 30 = 88.7 \text{ m}^3/\text{vit}$ , për pyjet me formë qeverimi shkurre,

Nga sa më sipër rezulton se mundësia vjetore e shfrytëzimit në EP Papadhi Çipin është 2190 m<sup>3</sup>/vit dhe në 10 vitet e maturimit të këtij plani nga kjo ekonomi duhet të hiqet një sasi lëndë drusore prej  $2190*10 = 21'900 \text{ m}^3$  lënde drusore.

Nga prerjet vjetore të llogaritura në përputhje me gjendjet reale të grumbujve pyjorë, sipas urgjencave, në programin Mc Access DB, sasia e materialit drusor që do të hiqet është 21 252 m<sup>3</sup>.

Nga sa më sipër, rezulton që mundësia vjetore e llogaritur me metodën Von Mantel, është krejtësisht e përshtatshme dhe në përputhje me gjendjen e grumbujve pyjorë të kësaj ekonomie.

#### IV. PLANI I INVESTIMEVE DHE TE ARDHURAT.

Pwr shkak tw terrenit tepwr tw thepisur dhe skeletik, marrw nw konsideratw edhe pasojat e ndryshieve klimaterike, pyllwzimet ne kwtw eknomi pyjore janw shumw tw vwshtira pwr tw qenw tw suksesshme. Pwr kwtw qwllim nuk janw planifikuar punime pyllwzimi.

Poa shtu edhe gjendaj e kullotave lw pwr tw dwshiruar, por nw sawj tw rwnies sw kwrkesws pwr kullotje, ndwrhryja me investime nuk justifikon vlerat e shpenzuara.

Tabela e meposhte paraqet te ardhurat nga lenda drusore sipas prerjeve te lejuara gjate zbatimit 10 vjeçar te punimeve dhe qerat nga makzimizimit te ardhurave te kullotave etj.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia ne 10 vjet	Çmimi për njësi (lekë)	Vlera gjithsej (lekë)
1	Dru zjarri	m <sup>3</sup>	21 900	600	13'140'00
2	Dëllinjë e Kuqe	ton	15	150'000	2'250 000
3	Sherebelë	ton	13	200'000	2'600'000
4	Trumëz	ton	8.7	180'000	1'566'000
	<b>Gjithsej</b>				<b>19' 556'000</b>

#### V. VOLUMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISË PYJORE.

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, pasi të dhënat u bartën në programin e përpunimit të të dhënave MS Access DB, të miratuar nga Këshilli Shkencor i ish Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave në vitin 2000, rezultoi se EP Papadhi Çipin ka një volum të përgjithshëm në këmbë prej 209'622 m<sup>3</sup>. Ashtu si më sipër kemi theksuar, volumi i përket vetëm formave të qeverimit Trungishte, cungishte dhe shkurre.

Të dhënat për shpërndarjen e volumit jepen në tabelën më poshtë.

Forma qeverimit	Volumi (në m <sup>3</sup> ) sipas Funkcionit		TOTALI
	Prodhues	Mbrojtës	
1   <b>Trungishte</b>	33'237	123'124	156'361
2   <b>Cungishte</b>	28'774	19'819	48'593
3   <b>Shkurre</b>	4668	0	4668
<b>TOTALI</b>	66'679	142'943	209'622

Ashtu sikur mund të vërehet edhe nga tabela më sipër, dominancën e volumit në ekonomi e mban forma e qeverimit Trungishte e cila sigurisht që është në porpcion të drejtë edhe me madhëinë e sipërfaqes.

Referuar nenit 11, pika 2 shkronja “b” të ligjit 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, përcaktohet se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore si dokument bazë afat gjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare, hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përfundimisht për Bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës.

Në këto kushte, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (struktura e shërbimit pyjor) në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin, shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kulloror pjesë e territorit të Bashkisë Himarë, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, *i propozon Këshillit Bashkiak Himarë për miratimin paraprak si dhe Ministrisë Mjedisit, në cilësinë e organit vendimarrës, miratimin përfundimtar të Projekt Draft planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Papadhi Çipin”.*

1. Mbarshtrimi është planifikimi afatëgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/ gjëndjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat administruese, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.
2. Ekonomi pyjore është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarshtrimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

**PËRGATITI MATERIALIN:**

**Konceptoi:**

**Specialist Pyjesh:**

**Ing. Ilija Dhimojani**

**Miratoi:**

**DREJTOR**

**Arjan Panajoti**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHËR  
ZËVENDËSKRYETARI**

**Erifili Berberi**

